



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2020:020540

Datë: 02.11.2020

Numri i dokumentit: 01234795

C.nr.184/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtaren Mirvete Alidemi dhe bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen kontestimore të paditëses B. M. nga Gjilani, të cilin e përfaqëson Malsore Halili avokate nga Vitia, ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit - Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilani, të cilën e përfaqëson, përfaqësuesi ligjor Arben Mehmeti nga Gjilani, me objekt kontesti- kompensimi i ushqimit dhe udhëtim, vlera e kontestit 1,398.60 euro, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor më datën 9 Tetor 2020, jashtë seancës gjyqësore më datë 26 Tetor 2020, mori këtë:

AKTGJYKIM

I. MIRATOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses B. M. nga Gjilani, e paraqitur ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit në Gjilani dhe **DETYROHET** e paditura që paditëses B. M., t'ia paguaj kompensimit e ushqimit ditor për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri më datën 11.03.2020, shumën e të hollave prej 1,036.00€ (për 518 ditë pune), si dhe për shpenzime të udhëtim në relacionin Gjilani-Cërnica dhe anasjlltas shumën e të hollave prej 362.60 €, respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,398.60 €, tërë këto në afat prej 7ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërkënimin e përmbarrimit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjilanit që paditëses B. M., në emër të shpenzimeve të procedurës , t'ia paguaj shumë monetare prej 373,80 €.

A r s y e t i m i

Paditësja B. M., përmes përfaqësuese së sajë, në padinë e datës 11.02.2020 të dorëzuar në këtë gjykatë, shkresën për rregullimin e paditësi të datës 23.07. 2020 dhe gjatë shqyrtimit kryesor ka kërkuar nga Gjykata që ta miratoj kërkesëpadia e paditëses për kompensimin e ushqimit ditor për 518 ditë punë , duke llogaritur nga data 18.04.2017 e deri më datën 11.03.2020 në shumë prej 1,036.00 euro, si dhe shpenzimet e udhëtimit në relacionin Gjilani –Cërnica dhe anasjlltas në shumë prej 362.60 euro/cent , duke u bazuar në nenin 35 paragrafi 7 dhe 8 të Kontratën Koletive të Arsimit të Kosovës, për shkak se është në marrëdhënie pune në SHFMU “ ...” në fshatin .. dhe në Paralelet e Ndara Fizike në fshatin ...dhe ..., e gjithashtu edhe për faktin se deri më tani nuk është kompensuar nga e paditura edhe pse ka paraqitur kërkesë para se të filloi procedurën në gjykatë, tërë këtë në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi më dt. 19.06.2020, të cilën e paditura e ka pranuar më dt.25.06.2020, ndërsa përgjigjen në padi e ka ushtruar me datë 29.06.2020. Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do t'i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, për mundësinë që gjykata të marrë aktvendim për shkak të mosbindjes.

E paditura në përgjigje në padi dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor e ka kundërshtuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses B. M., duke e konsideruar si të pabazuar për faktin se DKA-Komuna e Gjilanit, nuk është përgjegjëse për moszbatimin e kontratës Kolektive të Kosovës të vitit 2017, të cilën e ka nënshkruar Ministria e Arsimit dhe SBASHK, duke theksuar që Ministria e Arsimit si palë nënshkruese e Kontratës Kolektive, ka përgjegjësi për të siguruar buxhetin shtesë për zbatimin e kësaj kontrate, andaj ka kërkuar nga Gjykata që kërkesëpadia e paditëses të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata për vlerësimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në këtë çështje juridike në procedurën e të provuarit i ka administruar këto prova materiale, Kërkesën për kompensim, adresuar DKA-së në Gjilan më datën 12.12.2019, Vërtetimin mbi përvojën e punës në Shkollën Filllore dhe të Mesme të Ulët “...” në fshatin ... dhe në Paralelet e Ndara Fizike në fshatin .. dhe ... me nr.të protokolit 149 i dt.16.12.2019, Listën e pagave për paditësen, Vërtetimin e përvojës në punës dhe ditët e punës në s SHLMU “...” me nr.të protokolit 283 i dt.10.07.2020, Vërtetimi i dt.03.06.2020 i Shoqatës së Transportuesve të Udhëtarvëe “Ana Morava” si dhe Lista e çmimores së biletave dhe Çertifikata e Vendbanimit të datës 22.09.2020, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjilan..

Pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK si dhe në bazë të rezultatit të gjithmbarshëm të procedurës kontestimore, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Se paditësja B. M. ka themeluar marrëdhënien e punës në vendin e punës në SHFMU “Ramiz ...” në fshatin ... në kohë të pacaktuar si mësimdhënëse e mësimit klasor dhe akoma është në mardhënine pune, ku gjithësjet përvojë pune në këtë shkollë ka 8 vite, dy muaj e 17 ditë, fakt ky i vërtetuar nga vërtetimi me nr.rendor 149 i dt.16.12.2019, lëshuar nga drejtori i shkollës S. Sh.

Nga Listën e pagave për paditësen B. M., gjykata vërtetoi faktin se e njejta pagën bazë e ka 421 €.

Nga Vërtetimin e përvojës së punës dhe ditët e punës në shkollën fillore “...” me nr.të protokolit 283 i dt.10.10.2020, gjykata vërtetoi faktin se e njëjta nga data 18.04.2017 e deri më datën 11.03.2020 ka gjithësejt 518 ditë pune.

Nga Vërtetimi i dt.03.06.2020 i Shoqatës së Transportuesve të Udhëtarvëe “Ana Morava” dhe Lista e çmimores së biletave gjykata vërtetoi faktin se bileta një drejtimëshe kushton 0,50 cent ndërsa anasjelltas për dy drejtim kushton 1 euro.

Nga Çertifikata e vendbanimit me nr.seri B 1.... të lëshua rmgj Zyra e Gjendjes Civile në Gjilan gjykata vërtetoi faktin se e njejta vendbanimin e tanishëm e ka në Gjilan dhe atë në rr.””III nr..

Gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditëses dhe lartësisë së saj, ka zbatua dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të dt.18.04.2017 e cila

ka hyrë në fuqi menjëherë) konkretisht nenin 35 par. 5 dhe 7 të kësaj Kontrate , ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimrore në fuqi.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi që të aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit duke e obliguar të paditurën që paditëses B. M. nga Gjilani, t'ia paguaj, në emër të kompensimit të ushqimit për periudhën kohore nga data 18.04.2017 e deri më dt.11.03.2020, shumën e të hollave në lartësi prej 1,036.00€(për 518 ditë pune), si dhe në emër të kompensimit të udhëtimit në relacionin Gjilan-... dhe anasjlltas shumën e të hollave në lartësi prej 362.60 €, respektivisht shumën e përgjithshme prej 1,398.60 €.

Ndërsa sa i përket shumave të aprovuara gjykata u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit Parauniversitare të dt.18.04.2017, ku neni 35 par.5, të po kësaj kontrate ku është përcaktuar se *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të bileteave të trafikut urban”* si dhe nenin 35.7 ku është përcaktuar *“Të punësuarve, u sigurohen kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë përnjë ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arismore.*Punëdhënsi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restauranit a kuzhinës ose në një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim, në rastin konkret institucionet shkollore nuk e kanë të rregulluar ushqimin përmes restauranteve, andaj edhe gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke u bazuar në nenin 452.1 të LPK-së, pasi që e paditura në rastin konkret ka humbur procesin dhe për këtë arsye vendosi që paditësit t'ia paguaj shumën prej 260.00€ dhe atë shumën prej 21€ taksën për padi, shumën prej 104 për përpilimin e padisë, si dhe dhe shumën prej 135 € në emër të përfaqësimit për një seacën të mbajtur. Sa i përket shumave të lartcekura gjykata u bazua në TA për avokat dhe në Udhëzimin Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, ndërsa e refuzoi pjesën tjetër sa i përket parashtresës adresuar DKA në shumë prej prej 80 € ngase kërkesa është paraqitur në administratën e DKA-së, pastaj parashtresa për rregullimin e padisë është e njëjtë me padinë në përjashtim të llogaritjes së ushqimit ditor, ndërsa për mbulljen e selisë së avokaturës nuk ka paraqitë provë të cilën gjykata do ta mirrte për bazë dhe për kota arsy shumat e kërkuara i refuzoi.

Gjykata administroi edhe prova të tjera materiale, por të njëjtat nuk i arsyetoi, pasi që ishin pa ndikim në vendosjen e çështjes.

Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, e në mbështetje të nenit 143 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN,
Departamenti i Përgjithshë- Divizioni Civil
C.nr. 184/2020, më datën 26 Tetor 2020**

Gjyqtarja,

Mirvete Alidemi

Numri i lëndës: 2020:020540
Datë: 02.11.2020
Numri i dokumentit: 01234795

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 ditë, pas ditës së pranimi të vendimit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.